




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë 17.09.2024, në ora 11:00, në sallën e bordit të drejtorëve.

#### **Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit Komunal të Skenderajt për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027, me Nr.04-400/01-0042674/24, të datës 30.08.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
5. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshmet të personit fizik Naim Vojvoda, me Nr.02-463/01-0042067/24, të datës 27.08.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z.Fadil Nura**);
6. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshmet të personave fizik Faik Vojvoda dhe Sadete Vojvoda, (bashkëpronësi), me Nr.02-463/01-0042070/24, të datës 27.08.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z.Fadil Nura**);
7. Propozim-vendim për miratimin e përfundimtar të ofertës nga Shprehja e Interesit, për marrjen në shfrytëzim afatgjatë (99), pronën e paluajtshme të Komunës me sipërfaqe prej 3000m<sup>2</sup>, ofertuesit personit juridik "Ismet Commerce" NTSH, me Nr.01-463/01-003936/24, të datës 14.08.2024, (Raporton anëtar i komisionit);
8. Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar me Nr.09-400/01-0043919, të datës 06.09.2024, i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Janar-Qershor 2024, me Nr.02-400/01-0043973/24, i datës 09.09.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z.Alban Shala**);
9. Të ndryshme.

**Kryesuesja:** Të nderuar anëtar KPF-së, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 5 anëtarë të KPF-së, mungon me arsye Besiana Thaçi.

-Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës së bashku me 5 pikat shtesë.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit Komunal të Skenderajt për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027, Nr.04-400/01-0042674/24, të datës 30.08.2024, (Raporton);

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Fjala përshëndetëse, Propozim vendim për miratimin e Buxhetit Komunal të Skenderajt për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027, një dokument i hartuar nga kryetari së bashku me ekzekutivin e komunës, që i ka kaluar gjitha fazat e nevojshme rreth hartimit të buxhetit. Buxheti për vitin 2025 do të jetë 19,881,471.00€, ky buxhet do të

financohet nga burimet e përhershme nga grandit qeveritar dhe të hyrat vetanake. Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve do të ketë 2,846,807.00€, shpenzimet komunale do të jenë 287,300.00€, subvencione 1,147,000.00€, dhe projekte kapitale 4,579,591.00€, që janë të pranishme për dy vite të ardhshme, dhe në fund janë projektet kapitale, kush ka pyetje jam këtu për çdo përgjigje..

**Kryesuesja:** E hap debatin, nëse nuk ka, konstatohet me (3) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit Komunal të Skenderajt për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Naim Vojvoda, me Nr.02-463/01-0042067/24, të datës 27.08.2024, (në mungesë të kryetarit raporton zyrtarja e DGJKP-së);

**Blerta Dobra-Geci;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni propozim vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Naim Vojvoda. Prona e paluajtshme në pronësi të Komunës së Skenderajt, ngastra Nr.554-3, me sipërfaqe prej 377m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e tërësishme prej 1897m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Skenderaj; Këmbehet; me pronën e paluajtshme në pronësi të Naim Vojvoda, ngastrën Nr.728-10, me sipërfaqe prej 377m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Skenderaj, evidentuar me certifikatë të pronësisë, (sipërfaqet janë vërtetuar sipas verifikimeve nga gjeodetët profesional të ZKK-së). Ky iniciim për këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme të personit juridik të lartcekur me iniciativë të komunës behet pas marrjes së pronës private të personit fizik në bazë të dokumenteve të planifikimit hapësinor për arritjen e qëllimit të interesit publikë, me rastin e realizimit të projektit të “ndërtimit dhe zgjerimit të rrugëve në qytet me kubëza betoni”.

**Kryesuesja:** E hap debatin, nëse nuk ka, konstatohet me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Naim Vojvoda.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personave fizik Faik Vojvoda dhe Sadete Vojvoda, (bashkëpronësi), me Nr.02-463/01-0042070/24, të datës 27.08.2024, (në mungesë të kryetarit raporton zyrtarja e DGJKP-së);

**Blerta Dobra-Geci;** Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personave fizik Faik Vojvoda dhe Sadete Vojvoda, (bashkëpronësi), Prona e paluajtshme në pronësi të Komunës së Skenderajt, ngastra Nr.554-3, me sipërfaqe prej 397m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e tërësishme prej 1897m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Skenderaj; këmbehet; me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik Vojvodës dhe Sadete Vojvoda (bashkëpronësi), ngastrën Nr.558-9, me sipërfaqe prej 253m<sup>2</sup>, dhe Nr.559-2, me sipërfaqe prej 144m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Skenderaj, evidentuar me certifikatë të pronësisë, (sipërfaqet janë vërtetuar sipas verifikimeve nga gjeodetët profesional të ZKK-së). Ky iniciim për këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme të personit juridik të lartcekur me iniciativë të komunës behet pas marrjes së pronës private të personit fizik në bazë të dokumenteve të planifikimit hapësinor për arritjen e qëllimit të interesit publikë, me rastin e realizimit të projektit të “ndërtimit dhe zgjerimit të rrugëve në qytet me kubëza betoni”.

**Kryesuesja:** E hap debatin, nëse nuk ka, konstatohet me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personave fizik Faik Vojvoda dhe Sadete Vojvoda, (bashkëpronësi).

Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e përfundimtar të ofertës nga Shprehja e Interesit, për marrjen në shfrytëzim afatgjatë (99), pronën e paluajtshme të Komunës me sipërfaqe prej 3000m<sup>2</sup>, ofertuesit personit juridik “Ismet Commerce” NTSH, me Nr.01-463/01-003936/24, të datës 14.08.2024, (Raporton anëtarit i komisionit);

**Blerta Dobra-Geci;** Propozim-vendim për miratimin e përfundimtar të ofertës nga Shprehja e Interesit, për marrjen në shfrytëzim afatgjatë (99), pronën e paluajtshme të Komunës me sipërfaqe prej 3000m<sup>2</sup>, ofertuesit personit juridik “Ismet Commerce” NTSH, Oferta me Nr.05-463/01-0036497/24, të datës 01.08.2024, personit juridik “Ismeti Commerc” NTSH, me pronar Ismet Mustafa B.I. nga Klina e Poshtme, është përfitues i Shprehjes së interesit publik, sipas njoftimit publik të komisionit vlerësues, me Nr.01-463/01-0037144/24 të datës 05.08.2024, në kohëzgjatje deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, për pronën e paluajtshme në pronësi të komunës së Skenderajt, si ofertë e vetme aplikuese, me të dhëna si në vijim: prona ipet në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme e komunës deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, me sipërfaqe prej 3000m<sup>2</sup>, të ndarë nga sipërfaqja e përgjithshme 11232m<sup>2</sup>, nga ngastra 699-2 Zona katastrale Skenderaj. Qëllimi i dhënies së pronës është për ndërtimin e objekteve me destinim afarizëm-banimi, sipas kritereve ndërtuese të përcaktuara nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit

**Kryesuesja:** E hape debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (3) vota për, (2) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për miratimin e përfundimtar të ofertës nga Shprehja e Interesit, për marrjen në shfrytëzim afatgjatë (99), pronën e paluajtshme të Komunës me sipërfaqe prej 3000m<sup>2</sup>, ofertuesit personit juridik “Ismet Commerce” NTSH,

Vazhdojmë me piken 8 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar me Nr.09-400/01-0043919, të datës 06.09.2024, i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Janar-Qershor 2024, me Nr.02-400/01-0043973/24, i datës 09.09.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, Alban Shala me qenë së drejtori mungon ju ftoj me votua me rekomandua për asamble e diskutoni ne kuvend;, fjalën ja kaloj;

**Mentor Mehmeti-PDK:** Kërkoj nga drejtori se disa dokumente te kjo pikë janë të pa dukshme dhe kërkoj që në kuvend me i sjell tjera qe duken me pastër.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar me Nr.09-400/01-0043919, të datës 06.09.2024, i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Janar-Qershor 2024.

Vazhdojmë me piken 9 të rendit ditës:

Të ndryshëm, a ka dikush me shtua diçka, nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, për datë 25.09.2024, në ora 10:00, gjitha të mirat.

Procesmbajtës



Kryesuesja e Kuvendit